



**Arber Shabanaj & jembiter**-liber  
Schriftsteller/Writer/Shkrimtar

# LISI I GJAKUT (Kur fjalët vrasin)



## **Të dashur lexues,**

më lejoni, t'ju prezentoj veprën time të botuar. Është një ndër veprat e para në fushë të letrave, por jo e para vepër e jetës s'ime. Se një tjetër vepër, si një ndër komandantët e një njësie të UÇK-së në Kosovë, unë me shokë, e kam shkruar gjatë luftës për liri. Pra, ky është një ditar i atyre ditëve të zjarra, kur rinia kosovare (dhe jo vetëm ajo) hodhi pushkën në sup, dha edhe jetën, që të zbohej nga vatrat uzurpatori shekullor serb dhe liria të përflakte çdo zemër shqiptare.

Siç edhe do ta lexoni, libri ka shumë jetë, shumë dashuri e mbi të gjitha shumë vërtetësi. Detyra ndaj Kosovës së robëruar, me sakrificën sublime e heroizmin, janë të shkruara organikisht e bëjnë apel, sidomos për brezat që do të vijnë; që kurrë, në jetë të jetës, të mos harrojnë kalvarin shekullor të Kosovës për të mbërritur tek liria e pavarësia.

Si dëshmitar e protagonist i atyre viteve të zjarra, unë, si autor, nuk lë të pidentifikuar asnjë problem. Edhe pse mbajta në beteja flamurin e UÇK-së, edhe pse isha komandant i një njësie luftarake, e cila ka shkruar me gjakun e dëshmorëve historikun e saj të lavdishëm, unë kam kurajon të ngre zërin e të themë disa gjëra për komandën eprore, se si disa punë e veprime duhej e mund të ishin bërë më mirë. Gjithsesi unë, si komandant i ri në moshë, por jo në mendime, jam krenar për çfarë kam bërë me shokët e mi. Këtë, përmes faqeve të librit, lexuesi e ndjen - sikurse e ndjen edhe modestinë - se

çdokush, që kishte në deje gjak shqiptari, këtë sakrificë ia kishte borxh Atdheut dhe Kosovës.

Ngadalë, kaluan dy dekada, qëkur Kosova është e lirë dhe pranverat e para kjo tanimë i celebron si e pavarur. Në varret e të rënëve ka veç lule të freskëta. Kështu do të ketë në çdo stinë të vitit. Janë këto lulet e shpirtit të Kosovës, të cilat për të rënë nuk do të vryshken kurrë.

Të gjitha këto, unë si autor, i kam thënë me detaje dhe vërtetësi. Po ashtu, jam munduar që në këtë libër të punoj me kujdes në sferën e literaturës, duke bërë maksimumin tim që t'i qëndroj besnik Shqipësisë standarde. Duke ditur se historiati i kombit tonë, shumë të çmueshëm Shqiptar, tanimë nuk trashëgohet vetëm gojarisht, por - fatlumësisht - ky transferohet edhe me shkrim, kështu në veprën time janë të interpretuara në formën më të drejtë të vërtetave e pathëna, të cilat kanë ngelur në pluhurin e harresës. Por jam i bindur, se ky kapitull historik, kaq kapital, i emërtuar si panteon i një kombi, nuk lejohet kurrë që të tretet në pluhurat e harresës. Sepse vetëm kështu mundemi njëhere dhe përgjithmonë të mësojmë nga gabimet.

Libri përbën një kontribut, jo të papërfillshëm, për historikun e Luftës Çlirimtare të UÇK-së e të Kosovës martire dhe, si i tillë, shpresoj se çmohet nga lexuesit, që do ta marrin në duar. Në vazhdim ju afrojmë leximin provues të librit tim të sipërpërmendur - "Lisi i gjakut" ("Kur fjalët vrasin"). Me nderime dhe respekt, ju falënderoj! Arber Shabanaj, qershor 2024



Arber Shabanaj  
Lisi i gjakut  
(Kur fjalët vrasin)  
Roman  
324 faqe  
ISBN 978-3-7584-5595-7  
19,99 EUR  
Shtëpia Botuese „Neopubli GmbH“ / „Epubli“  
10997 Berlin  
1. Auflage April 2023  
&  
336 faqe  
ISBN 978-9928-3122-3-5  
Çmimi: 1000 Lekë  
Shtëpia Botuese Agora  
Tiranë, nëntor 2023

Ishte luftë e në luftë ka edhe gabime. Teoritë dhe filozofimet jua kishin lënë vendin bombardimeve dhe krismave të pambaruara. Tani ne ekzaltoheshim nga goditjet e NATO-s përmbi pikat strategjike ushtarake të Beogradit dhe tani thoshim; dashtë Zoti t'a ruaj Amerikën e ne ta kemi atë shtet të Zotit vazhdimisht pranë vetës. E jo - kursesi t'i linim vetvetes ndonjë pikëpyetje iluzore e - më pas të mendonim se Amerika do të tërhiqte dhe këmbëzat e pushkëve, të cilat ne i kishim në supe. Jo, jo, ne - dhe vetëm ne - tok do ia sillnim lirinë asaj toke të përgjakur, e cila e ka emrin Kosovë!

Po a nuk është më mirë që kjo të kuptohet dhe zbrërthet siç edhe duhet: P.sh., gjermanët e fituan të drejtën, mbas 54 viteve, të merrnin pjesë në një luftë! Këta edhe e kanë pasur ëndërr të marrin pjesë në një luftë! Njëkohësisht këta, pra gjermanët, edhe jua testonin forcat dhe strategjitë rivalëve të tyre të përhershëm; pra anglezëve dhe amerikanëve! Ndërsa këta dy të fundit -, me moton; meqenëse njerëzimi nuk e sheh Perëndinë e vet me sy, atëhere ne edhe jemi vetë Zoti i njerëzimit -, vinin në provë armët më moderne. E këto shpërthenin edhe nëpër lagjet apo karvanët njerëzore kosovare (edhe pse kërkohej falje-kinse sulmet e atilla qenkan realizuar paqëllimshëm dhe gabimisht). Përderisa deri dje fëmijët e shqiptarëve, akoma pa rënë drita në tokë, zgjoheshin të trembur e strukeshin në krahët e nënave, ngase "Mig"-ët (pra, aeroplanët bombardues të shkijëve) fluturonin vetëm pakëz sipër çatave të tyre!

Në atë situatë, ne, shqiptarët, më mirë se kurrë ishte dita t'a prezentonim veten këta që jemi! Që thjeshtë veprat tona të mira të flasin, ndërsa fjalët të heshtin! Edhe pse tani për tani ndoshta jemi të rrëzuar, ne duhet të dijme se si të ngrihemi shpejt, njëherë e përgjithmonë, të ngrihemi mirë e të mos rrëzohemi më kurrë apo të përbaltemi në sytë e Botës! Kjo do të ishte "diagnoza" më e mirë gjithpopullore për ne në këto kohëra të vështira dhe shndërrimesh të mëdha gjeopolitike.  
(nga faqja 179 e librit).

I shihja sërisht ushtarët e huaj jashtë dritareve të autobusit; ata ngjanin ekstrem të ftohtë, se mbase edhe vinin nga vendet nordike. Seç e kisha një bindje se ata trupa do të hynin në Kosovë, pasi që lufta të ketë mbaruar! Ishin këta me ca fytyra të pagjakta, të cilëve - mbase në 70 % të jetës së tyre - ju ka qëlluar të konfrontohen vetëm me shiun, mjegullën e dëborën e asnjë vështirësi tjetër, pa lere më me mungesat jetike!

Ndërsa ne përshkoheshim ndanë tyre rrugës, apo kalonim ndonjë postbllok, edhe pse ishim ushtarë të një fronti, këta i drejtonin armët drejt nesh, thuajse po bënë patrullë ...

E unë i krahasoja ata me ushtarët e togës sime. Një ushtar i UÇK-së -, fjala vjen Astriti apo Samedini -, në të gjithë komponentët që e përcaktojnë një luftëtar të kohës moderne, ndoshta kishte vlerë sa disa nga ata marioneta kompjuteri, edhe pse njiheshin se ishin ushtarë të NATO-s. E ushtari i shkretë i UÇK-së, shpeshherë e posedonte armën, e cila nuk

*kishte as shenjestër precize dhe, e cila pasi që kishte zbratur afro 200 fishekë, pa bërë pushim prej disa orëve, shihje se asaj i ishte deformuar tyta! Këto diferenca më bënin sërish të mos ndjehesha mirë, kur e dija se NATO-ja e kishte atë potencial të na furnizonte edhe neve si ushtarët e saj, pasi struktura e saj ka mijëra armë e ushtari vetëm një jetë; si ai i NATO-s, poashtu edhe ai i UÇK-së! E megjithatë ushtarët e mi vijonin të brohorisnin: „NATO, NATO, NATO!”*

*Sinqerisht nuk më vinte aspak mirë kur përjetoja këto skena. Për më tepër me ushtarët e mi! Ngrihjen dhe edukatën e tyre të deritanishme, s'mundja t'i ndërroja dot brenda disa javëve e as brenda pak muajve!*

*(nga faqja 180 e librit).*

#### **Kapitulli IV**

*Elshan, data shënonte 24 maj 1999, ora 21:30.*

*Ishte aq rrëmujë, sa që nuk arrij dot ta përshkruaj. Disa i kishte përfshirë mallëngjimi dhe s'e flisnin asnjë fjalë, veçse, kur i shihje si të përhumbur, të ngjanin se ishin në ëndërr. Duke ecur ashtu - as nuk ju bëhej vonë dhe as që ju interesonte dot se - fusnin këmbët nëpër gropat e shumta, të cilat i ofronte terreni i atyshëm. Dhe vetëm i dëgjoje kur thonin „Hopa”, ngase, me gjithë përgatitjen ushtarake mbi supe, të ngjanin se zgjoheshin, pasi dikujt edhe i dhimbe këmba e lënduar ...*

*Disa të tjerë i kishin përfshirë emocionet dhe vetëm kur i dëgjoje se si me tërë forcën e zërit bërtisnin: „O shka, pritna se arritëm e na do ta ..... nënën!”. Kurse një tjetër pjesë e ushtarëve, të cilën mundeshe t'a radhisje në kolonën e tretë, e kishte rrokur edhe paniku si edhe e kishte lënë koncentrimi në baltë. Këta ushtarë -, duke e kthyer kokën sa anash, sa para, sa mbrapa, dukeshin në lëvizje si qesharakë -, sikur t'ju kishte humbur busulla orientuese, pa ditur se çfarë donin e çfarë kërkonin, vetëm ulërinin: „Ma shpejt, ej, ma shpejt, po çfarë po prisni?!”. E vetë ata ishin edhe më të ngathët se breshka, kishin ngelur në vend dhe s'dinin nga t'ia mbanin dhe as se kujt i takonin! E në atë ecje hasje edhe prej atyreve, të cilët vetëm se donin të binin në sy. Mirëpo fati i tyre i keq ishte fakti, se ato marshime e luftëra më së shumti zhvilloheshin natën, në errësirë, kështu që edhe nuk kishte se kush t'i shihte! ...*

*Më dukej se rrëmuja vinte duke u shtuar. E ndihesha edhe i brengosur pse ngjante ashtu, por edhe i gëzuar se togën time e kisha “top”, plotësisht në një hap e nën kontroll. Meqë në atë krahurë ecjeje, ishte sukses nëse tjetri nuk ta ngjishte automatikun në fytyrë, pasi, sikurse edhe në Burrel, ende disa automatikët i bartnin mu si bujqit atëbotë lopatat; pra mbi supe!*  
*(nga faqja 189 e librit).*

*Ndërsa tjetri, siç ishte më së miri, duke kaluar përskaj teje, thuajse pësoi goditje epileptike -, përderisa ishte duke folur me tjetrin -, zgjaste duart deri në maksimum, duke i thënë bashkëbiseduesit me zë të lartë e nervozizëm: „Hajt, bra mos*

m'ladh allajle há". E ty, për një fije, qe duke t'a futur me tërë forcën gishtin në sy! Të këtitëve nuk iu mjaftonte vetëm diskutimi, por iu duhej edhe artikullimi dhe gjestikulimi, thuajse po i shihte ndonjëri në atë errësirë.

Të gjithë ushtarët ishin të armatosur dhe kishin municion afër vetes. E kjo ishte edhe e rrezikshme -, nëse frikacaku bëhej me armë -, pasi jo vetëm nga pakujdesia, por më shumë nga ndonjë hije, e cila kishte mundësi t'i shfaqej diku papritmas, edhe mundte t'a shkrepnte armën pa e pasur të ditur se do të vrisje shokun përpara. E tipat e këtitëve veçse frikacakë (sa mirë që në rreshtat tonë ne nuk kishim shumë nga këta), kishin mbetur edhe adoleshentë, edhe pse moshën e pjekurisë qëmoti e kishin kaluar. Madje Drenica për këtë specie njerëzore e ka një thënie kuptimplotë: „Janë disa njerëz, të cilët i bëjnë edhe 50 vite e nga faza e pjekurisë nuk dalin!”.

E kështu edhe disa nga këta ushtarët e UÇK-së vetëm se i kishin mbushur armët.

Ishte aq errët sa s'mundje as këmbën tënde ta komandoje se ku do ta hidhej. Megjithatë, hera-herës dalloja disa nga ushtarët e togave të tjera, të cilët ishin me cigare në gojë, me njërin dorë në automatik e me tjetrën duke rrotulluar bajonetën si të ishte ajo lodër! Sigurisht që këta ishin ata, të cilët në Burrel më së shumti rinin përfundi hijeve, përderisa neve na shkonte djersa - në stërvitje - për lug të shtatit! Po nëse nesër në front këta e humbnin rrugën, mua më duhej t'i merrja me vete, si ushtarë të mi, në mënyrë që pakujdesia e djeshme, këtyre, të mos ju kushtonte nesër me jetën ...

(nga faqja 190 e librit).

„Vullneti 55, këtu Vullneti 62. Nuk është koha për lavdërim! Urgjentisht ju thuaj atyre t'i pushojnë granatimet, para se të m'i zhdukin ushtarët e mi!”

„Arber, këtu 'Barot', më dëgjon?”, m'u drejtua përsëri përgjegjësi për hedhjen e predhave, i cili gjatë bisedës sime me Fazliun vetëm se ishte përzier në lidhje!

„Të dëgjoj, 'Barot'”, iu përgjigja unë.

„Së pari, të lumtë Vullneti 62 se na e zbardhe faqen dhe së dyti, unë kam urdhër të granatoj!”, ma ktheu ai mua.

„Kë të granatosh, neve apo amikun? Vetëm një gjë ta dish 'Barot': Nëse një ushtar të ma plagosni, ngaqë nuk e ditkëshit se çfarë po bëni, nesër ose pasnesër do të jepni llogari. Ju betohem për këtë, ty dhe atij që ta ka dhënë këtë urdhër të granatosh, përderisa ne të apeluam të pushoni menjëherë granatimet, se po e merrni kështu mbi vete një peshë më të rëndë sesa mali i Pashtrikut!”

„Po m'i tregoni koordinatat se nga t'i hedhim predhat, Vullneti 62!”, m'u drejtua përsëri ai.

„Ti mendon se ne jemi këtu në dasëm e s'kemi punë tjetër, përpos ty të të japim koordinatat!? E ke bllokuar një togë të tërë, kinse qenkëshit 'toga e artilerisë', vetëm të m'i asgjësosh ushtarët e mi dhe të UÇK-së! Përndryshe të flas shkurt dhe Shqip: Nëse edhe një shekull granaton kështu, nuk ke për t'a arritur dot shkaun e as t'i bësh më të voglin dëm, sepse, ne këtu në front, i kemi rezultatet tuaja në pëllëmbën e dorës ...

Granatimet e tua deri më tani për serbët kanë qenë veçse 'dauille për valle' ..."

„Si!??”

„Kush ta merr mendja se je ti, 'Baroti'? Tani unë t'i thashë të mijat: Pushoni menjëherë granatimet, se këtu po luhet me jetërat e luftëtarëve të lirisë! Mjaft më! Dhe tani e tutje, s'kam punë më me ty, por me Vullnetin 55 dhe me eprorin 'Daja i vogël'! Fund, 'Baroti', iu drejtova atij përfundimisht.

(nga faqja 264 e librit).

„Vullneti 55, këtu 'Baroti'. Unë do të granatoj më tutje! Po serioz qenka ky njeri, o Fazli!", iu drejtua "Baroti" në vazhdim Fazliut.

„Ashtu është, Arbrin nuk mundesh me e nënshtu, 'Barot'! Granatoni më tutje, por me kujdes, në rregull?!", ia ktheu Fazliu atij, përderisa unë po prisja t'a dëgjoja nga Fazliu urdhërin e menjëhershëm të ndërprerjes së granatimeve.

Ç'kisha në dorë unë e bëra. Për disa minuta granatahdhësit tanë heshtën, por ndërsa ne po mendonim të ndërmerim veprimet e duhura, nisën sërish granatimet tona ... Granatonin dhe predhat përplaseshin edhe mbrapa shpinave tona! Thërmijat e këtyre predhave ishin të verbëra, mu ashtu si hedhësit dhe eprorët tanë të "lantë"!

Shkijet nuk hapnin zjarr akoma. As ata siç dukej s'donin t'ju besonin syve të tyre kur shihnin shpërthimet pranë dhe mbi pozicionet tona. Nga Isai, Nuhiu e Avniu, mbrapa nesh, nuk dëgjohej asgjë. Edhe Safeti me togën e tij kishte rënë në qetësi, siç dukej po prisnin sinjalin që do t'ju vinte nga ne. Sipër nesh, ndërkohë, lart në Qiellin kosovar, fluturonin aeroplanët e NATO-s.

Siç edhe e bëra të ditur, vetëm snajperistët, nga i gjithë efektivit i ushtarëve këtu, kishin të drejtën të hapnin zjarr, kuptohet, vetëm nëse ishin të sigurt se nuk dilnin bosh. Këta edhe tërë kohën e mbanin syrin në dylbitë e snajperit të vet.

Mora dylbitë në dorë dhe po vrojtoja. Snajperisti më bëri të ditur se armiku po merrte pozicionin e zjarrit. Me dorë iu bëra të gjithëve, edhe atyre, të cilët i përcaktova për të kontrolluar gjendjen e ushtarëve, që të ulëshin e të vendoseshin nëpër transhetë e tyre. Që të përgatiteshin për betejën e dytë!

(nga faqja 265 e librit).

Kishte shkuar ora 14:30 minuta e po kësaj dite. Në një vend, aty mbrapa murit me gurë, afër vijës tonë të zjarrit, ishin grumbulluar çantat me gjërat tona personale. Këto ne i patëm hedhur ashtu grumbull siç mundëm, sepse na duhej të operonim shpejt e të zinim vijën e zjarrit. Kështu ishte ndërtuar një shkurre prej çantave.

Papritmas, duke lëvizur me kujdes, po afrohej Ramizi drejt "shtabit" tim. I bëra me shenjë të strehohej pas grumbullit të

çantave, meqenëse vendi, aty ku unë qëndroja, ishte i ngushtë, sa për të më zënë vetëm mua!

Ramizi veptoi ashtu siç edhe i bëra unë me shenjë. Në dorë kishte një bllok shënimesh, me siguri se evidencën- 'sekretin ushtarak'! Atij iu afruan Arsimi, vëllai i "Bugarit" dhe Ahmeti. Po i shpjegonin për fatin dhe përparimin tonë të deritanishëm në betejë. Unë doja t'i afrohesha Ramizit e t'a përshëndesja, ndoshta edhe t'i raportoja, por para se të mbërrija tek grumbulli i çantave - "frriuuu", "frriuuu", "frriuuu" -, më vërshtëllën tri projektile, njëri pas tjetrit, pothuajsa m'i fërkuan edhe kapelën e këmishën. Ishin sërish snajperët e pa zëshëm të armikut.

Ashtu si isha, u hodha shpejt përdhe, mandej u ktheva me fytyrën lart e më shpinën për tokë, se projektilet po fluturonin fort ulët mbi sipërfaqen e trupit tim. Ata shtinë edhe disa herë mbi mua e këtë po e shihnin të gjithë, natyrisht se edhe Ramizi, të cilin unë e përshëndeta nga ky pozicion, se të flisja mundja, por të lëvizja assesi.

„Përshëndetjet e mia, Arber, për suksesin e deritanishëm! Sukseset që arritët ju brenda kësaj kohe, s'janë arritë diku tjetër edhe brenda disa muajsh luftimesh”, m'u drejtua Ramizi.

Këto fjalë, unë i citova tekstualisht pasi që këto, në momentin kur u thanë, kishin një peshë të veçantë dhe ndikonin për të ngritur sadopak moralin e ushtarëve.

Unë iu përgjigja:

„Ramiz, kjo është meritë e ushtarëve tanë të UÇK-së!”

„Arber, ruaju e mos lëviz fare, se të paskan vënë mirë në shenjstër snajperistët e armikut dhe duan të të likuidojnë!”, dëgjova sërish të më drejtohej ai mua.

Ahmeti dha urdhër të shtinin andej nga qëllonin snajperistët serbë dhe kjo më krijoi mua mundësinë të lëvizja e të takohesha me Ramizin.

„Ramiz, ja pikat e strategjisë dhe të veprimeve tona të ardhshme! Por, më përpara na duhet patjetër ujë dhe bukë! Një minutë e më parë! Na duhet municion e ndonjë mortajë dore. Shumica e mitralozëve të rëndë janë me defekte. Edhe telefoni im dhe ai i Ahmetit duhen mbushur”, i raportova unë atij, i cili po i lexonte pikat e mia dhe po shënonte çfarë gjykonte në bllokun e tij.

„U bë, Arber! Ty po ta marrë baterinë e telefonit me vete e së shpejti të vjen tjetra! Buka dhe uji janë për rrugë! Do të raportoj unë në komandë për sukseset tuaja të deritanishme”, tha Ramizi, i cili po bënte të largohej.

„Dhe nëse doni të përparojmë ca më tepër, atëherë këto kërkesa duhet të realizohen para se të ketë rënë nata, më kuptove Ramiz?! Se, po qe se nuk realizohen deri atëherë, mos prisni më ndonjë lajm të mirë prej neve. Ju bëj përsëri me dije se granatahdhësit tanë vetëm po shpenzojnë predha më kot, e - ashtu siç po veprojnë ata, seç e kam një parandjenjë të keqe - se do të vrasin ushtarët e mi! Kam këmbëngulur e këmbëngul përsëri që ata t'i pushojnë menjëherë granatimet. E nëse ndodh ndryshe, përgjegjësia bie mbi ju; mbi ty e mbi të



gjithë eprorët e tjerë. Unë kaq kisha”, iu drejtova Ramizit i revoltuar e për herë të fundit.

„U bë Arber, siç ju thashë, sa më shpejt!”, na premtoi sërisht Ramizi edhe kësaj radhe, i cili filloi të tërhiqej me kujdes nga mbrapa e të largohej nga ne. Po shpresoja të mos i linin prapë peng fjalët dhe premtimet ushtarake!

Ramizi dikur u largua nga rrezja e rrezikut, por çuditërisht edhe snjaperistët e armikut nuk shtinin më, prandaj e shfrytëzova rastin dhe u ngrita me kujdes që t'i afrohesha vendit tim.

„Shpresoj se kësaj radhe do ta mbajnë fjalën, Arber!”, mu drejtua Ahmeti.

„Shpresoj se po, Ahmet!”, ia ktheva unë.

„Nëse nuk përgatitemi deri në mbrëmje, ne do të mbarojmë këtu, Arber! Ja di unë taktikën shkaut! Edhe telefoni im së shpejti harxhohet dhe atëhere ngelim fare pa kontakt”, tha i shqetësuar Ahmeti.

„E di, Ahmet. E di edhe këtë ... Por unë nuk mundem t'i urdhëroj ushtarët të tërhiqen mbrapa. Këtu jemi të paktën shumë më të mbrojtur. Të presim e të shpresojmë se vërtetë në këtë radhë e mbajnë premtimin e nuk luajnë me jetët tona.”

Nuk zgjati edhe shumë e aty rreth orës 15:30-16:00 nga radioja me bateri e një ushtari dëgjuam lajmet e Radio Tiranës. Zëri i Shqipërisë i informonte shqiptarët, kudo që të kenë qenë,

se »në betejat e Pashtrikut, trupat e UÇK-së -, “nën komandën e eprorit tonë të lartë Hynsi Syla” (!) -, kishin marrë pikën e armikut dhe se e paskan thyer fortifikatën e tij. Armiku kishte humbje të mëdha në forca të gjalla ...«

Ky lajm në vijën e zjarrit edhe na ngrohte, edhe na brengoste. Nga heroizmi dhe qëndresa e ushtarëve të pangrënë e të pa pirë, përballë serbit, dikush donte të përfitonte. O Zot! Ai eprori që përmendej, por edhe të tjerët rreth tij, i kishin lënë luftëtarët e lirisë në zgrip të jetës e se këta heronj të vërtetë, as që jua kishin parë dot fytyrat këtyre eprorëve, të cilët as nuk kishin qenë fare këtej afër vijës së zjarrit! ... I ruanin prapanicat e veta, shumica qëndronin matanë kufirit, në Shqipëri. Dhe duke ngrënë suxhukë e mish të pjekur dhe duke pirë raki shqiptare, prisnin se mos po likuidohej ndonjë shka tjetër, në mënyrë që të lajmëronin mediat e të lavdëroheshin në emrin e luftëtarëve të lirisë, të cilët, krejt para meje, më ngjanin jo si njerëz, por si silueta; me buzët e plasaritura nga etja e me barqet boshe nga uria. Me mosveprimin e tyre, ata s'po bënin asgjë tjetër, veçse një shërbim armikut, i cili ende përgjonte nga strofulla e tij. E ndërsa lajmi përsëritej, granatimi më i fundit i artilerisë sonë, fare pranë transheve tona, që një paralajmërim serioz se diçka e kobshme do të na ndodhte. „Edhe analfabetët e hajnat e pulave i kanë lënë të granatojnë e të hedhin predhat mbi pozicionet tona”, mendova.

„Zotëri komandant, zotëri komandant e kanë plagosur një ushtar!”, m'u drejtua njëra nga sanitaret tona. Dhe, më besoni,

m'u bë sikur më ra bjeshka e Pashtrikut sipër e më zuri përfundi vetes. Çfarëdo më sillej nëpër kokë. Dhe ja viktima e parë! I shtrirë për tokë, sipas urdhërit në transhenë e vet, duke vështruar situatën para tij, e kuptova se thërmiat e granatës ia kishin pasur bluar koshin e gjoksit nga mbrapa.

Serbët nuk po granatonin akoma. Ora ishte 16:35 minuta dhe ja, m'a granatuan ushtarin e parë. Dy vrima të gjera po ia nxirrnin gjakun e valë pamëshirshëm nga trupi. Thërmiat e predhave (o Zot, thërmiat e predhave të artilerisë sonë!) ia paskan bluar edhe brinjët. I plagosuri nuk ishte ushtar i togës sime, por ky ishte Afrimi, i kompanisë sime, ishte vëllai im! Ai po dridhej, për pak edhe fytyra iu bë e verdhë, si e një të vdekuri, ngase po humbte shumë gjak!

Afrimi ishte i vendosur në krahun e majtë, kah mesi i kompanisë. Nga pozicioni i shtrirë po i kurajoja sanitaret, ndërsa ato po ia afronin ndihmën e parë. Deri sa arrita pranë të plagosurit, m'u desh të zvarritesha, meqenëse snajperistët e armikut po më gjurmonin. Nga transheja e ime - e deri tek i plagosuri - ishte një distancë diku rreth 100 metra. Ashtu siç e kisha parashikuar; e granatuan nga mbrapa, në shpinë!

Ushtarët i pushtoi paniku, sepse po e nuhasnin se, kështu si po granatonin tanët, edhe ata mundnin t'a kishin fatin e Afrimit. Granatimet nga bjeshka e Pashtrikut mundnin të shndërroheshin në qivur për të tjerët.

Më duhej prap të zvarritesha, rreth 100 metra. Po më shtereshin edhe mua fuqitë. Sepse unë isha gjithnjë i kërkuari i snajperistëve serbë.

Afrimit i ishte nxiirë tani fytyra dhe gjithandej dëgjoheshin gjëmimet e tij: „O nënë, o nënë! Shkova, o nënë!”, „Më ndihmoni, më jepni pak ujë!”, të cilat i bënin ushtarët e tjerë përrreth të ligështoheshin, edhe pse ndonjëri - pa pyetur fare se a e rrezikonte jetën e vet - i kishte ardhur pranë dhe i thoshte të bënte gajret e të duronte, se shpejt do t'a nisnin drejt spitalit më të afërt ...

„Ujë, një pikë ujë!”

O Zot, ne nuk e kishim një pikë ujë për t'ia njomur buzët!

Urdhërova Sametin dhe Ramadanin t'a bartnin Afrimin. Dhe, merreni me mend, këta të dy, me pushkët në krahë (Sameti dhe Ramadani ishin bartës të të plagosurve), duhej të ruheshin nga minat dhe t'i ngjiteshin bjeshkës së Pashtrikut me të plagosurin në duar. Urdhërova që prej andej Afrimin t'a dërgonin sa më parë në spitalin e Krumës.

Mbi fashat, të cilat ia kishin vënë sanitaret, skuqej gjaku i tij i freskët. Sa vinte e po terej në fytyrë. I thashë se do t'a shpëtonim, se plagët nuk ishin vdekjeprurëse e se në spital doktorët do ta shëronin ... Me sy më falënderonte se gjuha i ishte trashë nga plagët që po ia shtonin etjen ... Mendonte, me siguri, se ishte granatuar nga shkijet ...

„Afrim, mbahu, se ti do të shpëtoth! Nisuni, pra, vëllezër!”, ju thashë Sametit e Ramadanit. Me siguri se ruga do t'ju zgjaste rreth 5-6 orë. Lusja Zotin të shpëtonte! Më ishte molisur i tërë trupi dhe isha demoralizuar dukshëm. Dhe merreni me mend, akoma tanët po granatonin ...

„Arber, e sheh se ç'po bëhet?“, m'u drejtua Arsimi, ndërsa unë po zija vend në strehimin tim e po ngopesha me frymë.

„Të lutem, Arsim ...“, ia ktheva, duke i lënë të kuptonte se isha fort i goditur nga ajo që po ndodhte dhe se unë s'kisha forcë që t'a ndaloja.

„E sheh, Arber, edhe pse ju dhamë ultimatium që të mos granatojnë më, prapë se prapë më kot! Na e granatuan ushtarin e ndoshta ai do të vdesë rrugës“, tha Ahmeti duke shprehur keqardhjen e vet të thellë.

„Ahmet, të ngelet kjo në mes nesh, sepse, po qe se e kuptojnë ushtarët se po granatohen nga predhat tona, i rrokë paniku krejtësisht“, iu drejtova Ahmetit.

Bisedat tona po i dëgjonin edhe Bujari, Arsimi, vëllai i “Bugarit”, snajperisti im si edhe “Fexhi”. Kështu që, njëherë për njëherë, të tjerët nuk duhej t'a dinin! ...

„Arber! T'a merr mendja se ushtarët tanë hanë bar?! T'a merr mendja se këta nuk e ditkan se në transhetë e tyre nuk mundet t'i gjejë asgjë, pos mbrapa shpinës? Tërë kohën vetëm ne po hedhim predha e, edhe Afrimi, u plagos mbrapa shpine!“, m'u drejtua prap Ahmeti i brengosur e që po kërkonte shpjegim, të cilin ne do të duhej t'a kërkonim diku tjetër.

„Ke të drejtë, Ahmet! Por të paktën ne direkt, njëherë për njëherë nuk guxojmë që këtë t'jua interpretojmë ushtarëve, se këta demoralizohen edhe më tepër e atëherë e pati puna! Në rregull?! Dhe tani thirrë Fazliun në telefon e tregoi se çfarë po bëhet!“, iu drejtova Ahmetit.

„Në rregull, Arber, por ... ani se me kalimin e kohës do të dali gjithçka në shesh“, m'u përgjigj ai, ndërsa po e zbatonte urdhërin tim:

„Vullneti 55, këtu Ahmeti! Sapo e nisëm të plagosurin e parë për në Shqipëri. Është plagosur rëndë dhe është goditur nga artileria e jonë. Ju thuaj atyre se po na granatojnë mbi pozicionet tona, se - po vazhduan kështu - do t'na vrasin ushtarët“, iu drejtua Ahmeti Fazliut, prerë dhe i revoltuar.

„Do të flas tani unë me këta!“, iu gjegj Fazliu.

„Edhe një gjë, Vullneti 55: Akoma as ujë, as bukë, as municion, as bateria e telefonit nuk erdhi këtu! Çfarë po bëni kështu, Vullneti 55?“

„Kuptova dhe do të kujdesem!“, ia ktheu Fazliu, duke i përsëritur edhe njëherë premtimet, të cilat tashmë ishin bërë bajate!

Me vullnetin tim të mirë, duke dëshiruar që të funksiononte të paktën diçka siç duhej ... meqenëse ishim ushtri ... unë dërgova korrierin tim, ushtarin Ferat Alushaj, drejt eprorit “të lartë”, që t'ia dorëzonte atij personalisht mesazhet e mia nga fronti i luftës ... Si epror i kësaj kompanie nga vija e zjarrit, duke e ditur se me ushtarët e mi unë po ndaja të mirën dhe të keqen, Feratit ia dhashë me vete pikat e mia, të cilat më herët unë ia pata interpretuar Ramizit. Te ne thuhet: „Nuk kam dëshirë të vdes pa gojë!“ ... Ferati ishte ushtar shumë i zellshëm, kështu që ky u nis bjeshkës përpjetë me vrap, për t'a dërguar mesazhin tim nga bjeshka e Pashtrikut!

(nga faqet - 276, 277, 278, 279, 280, 281 dhe 282 - e librit).

*Kjo betejë do të zgjaste edhe më shumë e ushtarët assesi të nervozoheshin, të mos vepronin pa komandë, sepse kështu do të bënin një gabim fatal për veten e tyre dhe për shokët. Dhe se komandant Arberi, deri në fund të kësaj beteje, do të jetë me ta, në vijën e zjarrit!*

*Edhe pse ndoshta unë nuk do të kisha mundësi të lëvizja aq shpesh, ngase po binte errësira dhe projektilët e panumërta nuk do ta mundësonin lëvizjen time të shpeshtë dhe të gjatë, ata vetë duheshin të ruheshin dhe të vepronin me zgjuarsi! T'i përcjellin komandat që do të vijnë nga komandant Arberi, t'a dinin se si, kundër kujt dhe kur të hapnin zjarr ...*

*Vartësit, të cilët i kisha këtu, në vijën e parë të zjarrit, po i zbatonin urdhërat e mia dhe këto i përçonin besnikërisht tek çdo ushtar.*

*Ishte ora 19:35 e kësaj dite. Deri më tani nuk arriti as bukë, as ujë e as bateria e mbushur për telefonin tim, as armët e rënda, as nuk u zëvendësuan armët me defekte, as municionet! ... Asgjë! ...*

*Kishim ngelur këtu dhe para nesh e kishim një betejë, e cila mundte të ishte edhe më e tmerrshme dhe më fatale për ne dhe për nderin e UÇK-së. Ushtarët e mi e të kësaj beteje, nuk kishin momentalisht asgjë tjetër, përveç meje ...*

*Deri më tani e kam pasur të plagosur vetëm Afrimin.*

*Nga kodra e Pashtrikut, pa e marrë parasysh gjithçfarë kishte ndodhur, po granatohej edhe më me intensitet. Kjo më brengoste akoma më thellë, ngase më dukej se do të më rrezikoheshin edhe më tepër ushtarë! Ndoshta do të kishim edhe viktima, edhe pse disa herë me radhë ju kishim bërë apel t'i ndërprisnin granatimet.*

*Kështu, ne po futeshim në ofensivën kryesore dhe akoma nuk e dinim se nga kush të ruheshim më parë ...*

*(nga faqja 285 e librit).*

## **Kapitulli VI**

*Ishte ora 20:00 e kësaj mbrëmjeje. Mbi frontin e Pashtrikut kishte rënë errësira. Qielli ishte i hapur, mbretëronte kohë e kthjellët. Ishte kjo mbrëmja - e ditës së enjte -, e datës 27 maj, 1999.*

*Lart në Qiellin kosovar, bombarduesit e Aleancës tregonin sërish prezencën e tyre.*

*Me “frrërrërrë” (krismat dominuese të golinovit), të shoqëruara nga ato të mitralozëve të lehtë, të automatikëve dhe pushkëve dhjetëshe, u soll furishëm atmosfera e luftës. Me “fshshshiiiiuuu-buuuummmm” (eksplodimet e herëpashershme të aeroplanëve të NATO-s), të raketave që hidheshin nga ajri, të cilat kryqëzoheshin me gjëmimet e artilerisë së rëndë të armikut. Të shoqëruara nga një “bam”, që hapej përballë nesh, paksa më larg se vija e zjarrit të armikut*

(të tankeve të tij të renditura) e që përfundonte me një “buuummm” në bjeshkët e Pashtrikut e në fshatin Pogaj, të shoqëruara nga projektilët që niseshin varg Qiellit përpjetë (raketat kundër fluturakëve), për t’i asgjësuar aeroplanët e Aleancës, por të cilët kurrë nuk mundnin t’i arrinin. E të gjitha këto shpërthime të bënin - që për ca çaste - të mos ndiheshen se ku ishe; në Qiell apo në Tokë. Timpanet e veshëve të shungullonin gjatë!

E në mes të këtyre eksplodimeve, predhat e granatahedhësve tanë plasnin gjithnjë shumë afër, nga ana jonë e pasme.

Ishte kjo beteja e tretë e Pashtrikut.

Secili ushtar punonte sipas planit dhe komandës. Vetëm disa, si edhe më herët, gabonin në intervale dhe i shpenzonin fishekët kot.

(nga faqja 287 e librit).

I ngjante të “bekuarit Dullit” se llapjanët po na ngelkëshin pa poste (!) dhe nuk e linte këtë për nesër (...), por donte që tani ... gjatë kësaj lufte, duke rrezikuar kështu edhe jetërat e ushtarëve. I dukej se “Llapi” po komandohej nga tjetërkush dhe e harronte se në këtë luftë, për jetë apo për vdekje, kundër okupatorit serb, neve na urdhëronte Kosova, liria e saj, gjaku i derdhur në shekuj.

Më çudisnin Arsimi, Ahmeti, vëllai i “Bugarit”, “Fexhi”, këta burra kaq të matur, ushtarë të mirë, trima e shokë të vërtetë, që i jepnin hapësirë ëndërrave e veprimeve të tilla të “Dullit”,

duke e harruar se një mollë e krimbur - do të krimbte një kosh!  
Hej, bela, edhe kjo na duhej! Ndaj e llogarisja se ishin të gjithë të armatosur dhe se ne vetëm po luftonim kundër kundërshtarit-armikut, më duhej të punoja me “diplomaci”. Në anën tjetër, më duhej që këtij farë “Dullit” t’ja bëja me dije se deri sa unë t’a kisha komandën në dorë, misri do të hahej nga një kokërr ... Nuk bartja me vete as intriga e as nuk jua jepja shansin të tjerëve për këto, nuk duroja unë Burrel ... Këtu ne ishim në luftë, unë isha përgjegjës për jetërat e këtyre ushtarëve e nuk lejoja që ato t’i venin në pikëpyetje për diferencime të tilla lokaliste. Ushtarët unë i pata trajtuar e do t’i trajtoja jo si vartës, por së pari si vëllezër e do t’i ruaja deri në fund!

Po i flisja pa zë, nga zemra “llapjanit” tim, i cili në këto momente të vështira lufte kujdesej për të tjera motive, aspak të hijshme e të denja për një luftëtar UÇK-je! Por gjithsesi edhe të heshtja nuk mundja më gjatë. Atëherë, me cilësinë e komandantit, i thashë:

„Dullit, ulu shpejt, ulu dhe mos u ngrit më nga transheja deri sa të urdhëroj unë. Mos m’i motivo kështu ushtarët! Rri aty i shtrirë, se po të vret armiku!”

(nga faqja 289 e librit).

Lufta vazhdonte sërish e egër.

U ktheva në rrethimin tim me gurë. Më ishte tharë goja, sa që kur doja të jepja ndonjë komandë, më ngjiteshin buzët me njëra-tjetrën. Me zë të çjerrë arrita t’i komandoja të dy krahët e

kompanisë për të hapur zjarr. Disa ushtarë vepronin edhe me iniciativë, sipas situatës në front. Orë pas ore ata sikur piqeshin në veprimet luftarake që i kryenin.

E kisha përshtypjen se krahu i majtë i armikut (nga këtu krahu i djathtë i kompanisë sime), ishte dobësuar dukshëm. Prej andej nuk hapej më zjarr i fortë. Ndoshta edhe Safeti me ushtarët e vet vetëm se kishin vepruar nga mbrapa!

Shkijet kishin pësuar deri më tani shumë dëme në forca njerëzore. Gërshetimi i goditjes sonë me ato të aeroplanëve të NATO-s i kishte dhënë frutat e veta.

Errësira kishte rënë gjithandej. Kështu edhe projektilët përvëlues, të cilët porsa dilnin nga tytat e armëve -, meqenëse hasnin nëpër gurë -, shiheshin se si fluturonin nëpër ajër. Kanë qenë me mijëra e mijëra këso grimcash të kuqërrimta, të cilat dikur edhe zhdukeshin në atmosferë ... E kjo atmosferë, në këtë kohë, me siguri se as 0.01 m<sup>3</sup> nuk kishte më ajër të pastër! Veç tym e barot! Pluhur, tym dhe barot! Gjithandej piroteknikë. Një pjesë e madhe kishte depërtuar nëpër organizimat dhe mushkëritë tona!

Për një çast m'u kujtua shkencëtari Alfred Nobel, i cili gjithë jetën ia kushtoi studimit të barutit dhe lëndëve eksplozive dhe më së fundi e shpiku dinamitin. Shpikja e tij u investua edhe në sferën ushtarake. Dhe sot njeriu e shihte se sa kishte përparuar shpikja e tij. Shembulli më konkret ishte ai i

aeroplanëve të NATO-s, të cilët një ditë edhe në Beograd do ta gjunjëzonin agresorin tonë kriminel serb.

(nga faqja 289 e librit).

Ishin mburrur eprorët e mi me atë luftë, le të mburreshin prapë nëse ia arrinin. Unë me mbi 100 ushtarë nuk e bëmë atë luftë as për mburje e as për poste. Neve na thirri Kosova e iu përgjigjëm, na thirri e i dhamë gjithçka, edhe gjakun! Çfarë t'i jepnim më tepër?!

Dikur arritëm në stacionimin ushtarak, në Pogaj, aty ku eprorët piqnin suxhukë e pinin deri para syve tanë e stomaqeve tona të uritura, para trupave tanë, deri në alivanosje të stërmunduar!

Më interesonte ajo shtëpia e ngritur apo kulla dykatëshe.

U ngjitëm lart. Ajo ishte e mbushur plot e përplot me ushtarë, prej të cilëve disa ishin të policisë ushtarake të Burrelit, protagonistët e turpit! Nuk ju besonim syve as unë e as shokët e mi. Ndërsa ne luftonim e vriteshim përballë serbit, këta -, as më shumë e as më pak se dy togje -, flinin në krevate të buta ushtarake dhe shihnin në një televizor!!!

Flokët na ishin ngritur përpjetë. As në endërr nuk do të mundnim t'a shihnim një skenë të tillë!

Zgjohuni, maskarenj! Pashtriku është larë me gjakun e dëshmorëve e të luftëtarëve të lirisë e ju bëni pushime! Si

*mundni të rrini kështu kur ata që ranë në luftë, kanë mbetur të pa futur në dhe, kur plagët e luftëtarëve ende rrjedhin gjak!? Phu, farë e keqe!*

*Ndihesha edhe më keq! Eprorët që i linin këta të “rreziteshin” këtu ma neveritnin gjithçkafen nën atë strehë, të cilës i vinte erë e rëndë tradhtie!*

*Pas pak u shfaq aty edhe komandant “Ujku”, po ashtu ai i Burrelit. Në dorë kishte një pushkë moderne.*

*(nga faqja 305 e librit).*

***Ky ishte testi i leximit nga libri im “Lisi i gjakut” (“Kur fjalët vrasin”).***

*Eprori i lig është në gjendje që të shkrijë një armatë të tërë, vetëm që nesër të marrë për vete medaljen e gjakosur me gjakun e dëshmorit ...*

*Ushtarët e UÇK-së -, të cilët u morën dhe u mobilizuan me nxitim dhe u dërguan në vijën e frontit, pa u stërvitur siç duhet -, e dhanë jetën më shumë nga papërgjegjshmëria e eprorëve tanë se sa nga zotësia e armikut e për këtë një ditë, siç edhe e kam thënë, ata duhet të japin llogari! Ashtu siç një ditë, do të*

*japin llogari deri më një, edhe eprorët tanë të “lartë” të Pashtrikut, të cilët na hodhën në luftë pa bukë dhe pa ujë e me municion të pamjaftueshëm, i cili sa po vinte duke u shterur.*

*Nëse fragmenti i leximit ka arritur të zgjoi kureshtjen dhe interesimin tuaj, për mbështetjen tuaj në veprën time letrare unë do të isha shumë i lumtur. Libri mund të porositet në Buchhandel.de (Amazon, Thalia) & përmes Shtëpisë Botuese Agora (e gjeni në çdo librari. Lexojeni ...)*

***Unë, si shkrimtar dhe luftëtar i lirisë, jam kronist, dëshmitar, jo misionar i një botëkuptimi të caktuar. Me nderime dhe respekt, ju falënderoj.***

*Autori*

  
*Arber Shabanaj*

*Gjatë promovimit të romanit “Lisi i gjakut”, të autorit Arber Shabanaj, në Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, Ministria e Kulturës.*





# Autor Arber Shabanaj widmet sich den kleinen Dingen des Lebens

Der Lyriker lässt Gefühle in seinen zwei neuen Werken lebendig werden.

## Von Tanja Heil

Sorgfältig sind die Worte gesetzt. Manchmal ein wenig umständlich in dem Bemühen, alles ganz genau zu schildern. Denn Arber Shabanaj hat einen Blick für Details, widmet sich den Kleinigkeiten des Lebens. Gleich zwei Bücher hat der Wuppertaler Autor jetzt gleichzeitig in der Edition Garamond herausgebracht: den Gedichtband „Exkursion der Lyrik“ und „Schuhe der Scham“ mit Kurzgeschichten. „Ich hatte beide Projekte kurz hintereinander abgeschlossen“, erklärt Shabanaj. Drei Verlage hatten an den Werken aus zwei Jahrzehnten Schaffenszeit Interesse. Der Lyriker wählte den umtriebigen österreichischen Garamond-Verlag, der sich jungen Autoren widmet.

In einheitlichem Hellblau kommen die beiden Bände nun daher. Viele Hoffnungen, Wünsche und Ängste hat der gebürtige Albaner darin verarbeitet, der vor der Gewalt in seiner Heimat nach Deutschland geflüchtet war. Es ist erstaunlich, wie feinfühlig Shabanaj mit der erst im Erwachsenenalter gelernten deutschen Sprache umgeht.

„Der Leser soll schmunzeln, sich amüsieren und sieht sich schließlich doch einem schwerwiegenden Problem gegenüber.“

### **Arber Shabanaj**

Durch die Gedichte weht oft eine Schwermut, die aus der Erinnerung an Verluste kommt. Freiheit, die genommen wurde, Träume, die geplatzt sind. Auch die Liebe findet ihren Platz, doch häufiger bringt

Shabanaj schreckliche Erlebnisse in eine literarische Form. Die Geschichten spielen zum Teil in Wuppertal und bleiben doch fremd. Der kulturelle Hintergrund Arber Shabanajs mischt sich mit seinen Erlebnissen in Deutschland, etwa in der Bürokratie. Eindringlich schildert der Elberfelder die tiefe Kluft zwischen armen und reichen Familien. Er hinterfragt verschiedene Auslegungen von Moral und Anstand, von Scham und Selbstverständnis. Tiefe Gefühle, gerade junger Menschen, lässt Shabanaj in seinen Erzählungen lebendig werden. Und er verarbeitet seine Erfahrungen als Poet in einer Welt, die von



hoher Literatur nicht viel wissen will. „Der Leser soll schmunzeln, sich amüsieren und sieht sich schließlich doch einem schwerwiegenden Problem gegenüber“, erklärt Shabanaj.

» „Schuhe der Scham“ (19,80 Euro) und „Exkursion der Lyrik“ (16,80 Euro) sind in der Edition Garamond erschienen und können über den Buchhandel bestellt werden. [jembiter-liber.de](http://jembiter-liber.de)

WZ DONNERSTAG, 26. OKTOBER 2017



BALLINA | ACTUAL | BISHKOPJA | KËRKIMET | KËNDIET

Mbledhjet, Turm: ulet Vercenitshkëpavle, Mbledhjet Djeqarsh, Nënt. 28.2022 Shkup

### Mbledhjet në Shoqatën Pavarësia

Mbledhjet janë të rëndësishme në jetën tonë, sepse, si mund të mësonim në kërkim të programit aktual të shoqatës tona, por edhe mund të japim një kontribut të vlershëm për të. Ngjashmësi, kreativitet, komunikim dhe përvojat tona të mëdha janë faktorë të rëndësishëm në krijimin e ideave të reja dhe zbatimit të tyre në praktikë dhe mund të jenë një faktor i rëndësishëm në jetën tonë.

#### Shfaqjet aktuale

2022

26.11.2022 Shkup

#### NDARJA e Çmimit "PAVARËSIA" 2022



Prof. Dr. PAVEL STAVIČKI (Miles i Çmimit "Pavarësia" 2022)

Prof. Dr. Stavarik me kryetarin e Shoqatës "Pavarësia" Zhilov, Tyle

Lija e Etnicitet, J. Arber Shubaniq, me rastin e grantit të Çmimit "Pavarësia" 2022

30.11.2022 Shkup, ora 18:00 Koncerti festiv

koncerti i 110 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë

Adresa: Turm- ulet Vercenitshkëpavle i Statistiq Djeqarsh, Abstraste 1/2, 1000, Shkup

Shoqata Pavarësia - Organizim për Kulturën, Mbrojtjen dhe Sportin



Drejtshkruar: Shkup, Organizim për Kulturën, Mbrojtjen dhe Sportin



## Jetëshkrim

Të nderuar miq të letërsisë,

unë çuhem Arber Shabanaj, i lindur më 08 mars, 1970, në Gjakovë. Rrugën time drejt letërsisë e kam nisur me poezinë. Që në gjimnaz e më pas, përgjatë studimeve në universitet, poezia m'u bë shoqëruese dhe kështu, duke ecur, ne nuk iu ndamë më njëri-tjetrit.

Punën dhe veprimtarinë time të palodhshme për të drejtat dhe lirinë e popullit tim, i trajtoja si diçka krejtësisht legjitime dhe që në kohën e regjimit të egër sllav kërkoja liri krijimi. Unë nuk kam qenë disident! Atë që më ka thënë zemra e kam shprehur. Kuptohet se edhe për këtë organet e dhunshme qeveritare dhe policore sllave, të cilat ishin të instaluar në Kosovë, më maltretuan sidomos në Verën e Vitit 1991 pa fije mëshire fizikisht dhe, për të kuruar plagët dhe shpëtuar jetën time, u përdoqa me dhunë nga Kosova dhe u detyrova të emigroj politikisht në Gjermani, ku unë jetoj dhe punoj. Libra unë shkruaj, sikurse në gjuhën Shqipe, edhe në atë Gjermane dhe veprat e mia munden të porositen përmes „Buchhandel.de“ (Amazon, Thalia):

„Das Gericht des gelobten Rechtsstaates“, „Das Haus in der Savanne“, „Der Befreiungskrieg, wie ich ihn erleben musste“, „Die Glocken der Stille“ dhe vepra të tjera të mia pothuaj i begatojnë vitrinat e literaturës gjermane. Falënderime të përzemërta.

Arber Shabanaj

# Katalog

2023/2024



**Arber Shabanaj & jembiter-liber**  
Schriftsteller/Writer/Shkrimtar

**Arber Shabanaj**

86316 Friedberg

E-Mail: [as-arber@live.de](mailto:as-arber@live.de)

Internet: [www.jembiter-liber.de](http://www.jembiter-liber.de)

